

Njoftim aplikimi për licencim

Në mbledhjen e tij të datës 06.01.2025, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GRABOVA HYDROPOWER” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Grabova”, me kapacitet të instaluar 14.9 MW, me vendndodhje në pellgun ujë mbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, Qarku Elbasan.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim nga data 07.01.2025 deri në datën 05.02.2025, pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.